VENDIM
Nr.101, datë 26.8.2008

PËR MIRATIMIN E KODIT TË MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 55 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2007 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike" pika 7, si dhe shtojca E, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.53, datë 23.5.2008 "Për fillimin e procedurave për disa ndryshime në kodin e funksionimit, të shpërndarjes së energjisë elektrike, kodin e sistemit të transmetimit, dhe kodin e matjes së energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.8.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi draftin e kodit të matjes së energjisë elektrike të përgatitur nga ana e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit të matjes së energjise elektrike.
(Kodi bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Shfuqizimin e vendimit nr.18, datë 29.3.2005 "Për miratimin e kodit të matjes së energjisë elektrike".

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta